

**RENOVA®***Innovation & Performance*

SILIKONHARZPUTZ

Detyrimisht përmbahuni udhëzimit teknik

FUSHA E APLIKIMIT

Material Akrilik , përzierje , e gatshme për përdorim të menjëhershëm, shtresë hollë, në granulacione të ndryshme , tekstura në dy variante V & R . Afatgjatë, strukturë fleksibile në nuansa të ndryshme për fasada të rëndomta dhe fasada me sisteme të jashtme izoluese Polisterol & Lesh mineral

PËRMBAJTJA

- Lidhës Akrilik
- Rrërë e bardhë mermeri
- Silikon (agjent lidhes)

VEÇORITË

- Vetë të larta hidrofobike
- Difuzive
- Përzgjedhje e gjërë ngjyrash
- Rezistencë të lartë ndaj kushteve klimatike

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Bazamenti duhet të jetë i thatë, i pastruar nga pluhuri, mbeturinat dhe yndyrnat. Kur vëndohet bazë të re (Llaç Renofix 10) varësisht nga direktivat e prodhuesit, nevojitet tharrje e bazamentit prej 2-3 javëve. Bazamenti detyrimisht duhet të jetë në tërësi I thatë Llaçi duhet patjetër të aplikohet sipas direktivave të prodhuesit për trashësinë e shtresës të caktuar dhe të thahet – më së paku 5 ditë (më gjatë në temperature më të ulta). Minimum

24h para vendosjes së shtresës përfundimtare, bazamenti duhet të lyhet me Renogrund paralyerje (astar). Parregullsitë në suvat bazë, paraprakisht duhet të rrafshohen me mbushës përkatës si p.sh Renofix 5,15,18 .

PËTGATITJA E MATERIALIT

Të përzihet mirë me mixer dhe të i shtohet sasia e ujit në bazë të udhëzimit më poshtë e dhënë , tërhiqet me mistrinë rafshuese deri në trashësinë e dëshiruar për aplikim.

PËRPUNIMI

Llaçi vendoset në sipërfaqet e murit me ndihmën e mistrisë rafshuese në trashësinë e nevojshme në trashësinë e granulacionit , materiali duhet të vendoset njëtrajtësisht pa ndërprerje. Strukturimi i materialit të vendosur: kryhet me diskun fërkues nga PVC. Pastroni mjetet e përdorimit menjëherë pas përdorimit . Temperaturat e ulta dhe lagështia e lartë e ajrit e zgjatin kohën e tharrjes. Absorbimi i ngjyrës jo një trajtshëm mund të ndikojë në ndryshimin e nuancës. Tretja shumë e lartë si dhe përpunimi në kushte klimatike jo të rregullta (erë e fortë, intenzitet i lartë i rrezeve të diellit) ndikon në krijimin e plasaritjeve. Koha e tharrjes varësisht nga lagështia e ajrit dhe temperatura mund të jetë 2 ditë, tharrja e plotë mund të arrihet pas 1 jave. Nuk lejohet përdorimi në temperature nën +5°C. Deri në tharrje të plotë të mbrohet nga ngricat, nga tharrja e përshpejtuar (dritë direkte e diellit, apo tharrëse jo natyrale) si dhe rreshjet e rrjedhshme (shiu).





VËREJTJE

Trashësia e shtresës vëndohet në trashësi të granulacionit. D.m.th sa është grimca aq duhet të jetë shtresa. Hapësirat që nuk duhet të mbulohet me material qoft dritare, hapje apo hapsira të tjera duhet të mbulohet dhe mbrohen. Me mistrinë rafshuese (gletkele) të çelikut arrihet trashësia dhe struktura e njëtrajtshme.

FURNIZIMI

Në kova prej 25 kg, të mbrojtura nga lagështia.

DEPONIMI

Të deponohet në hapësira të thata, mbi paleta të drurit. Afati i deponimit 12 muaj në ambalazhimin original.

TË DHËNAT TEKNIKE

Shifra e prodhimit						
Njësia sasiore:	25 kg/në kovë					
Kova në paletë	24 kova/ paleta					
Granulacioni	1 mm	1.5 mm	1.5 mm	2 mm	2 mm	3 mm
Ngjyra	E bardhë					
Struktura	V	V	R	V	R	R
Harxhimi	ca.2.0 kg/m ²	ca.3.3 kg/m ²	ca.2.7 kg/m ²	ca.3.5 kg/m ²	ca.2.7 kg/m ²	ca.3.5 kg/m ²
Dendësia e materialit kur është i thatë (EN 1015-10)	ca 1.600					
Përçueshmëria e nxehtësisë (1745 :2002)	ca.0,83 W/mK					
Fortësia gjat shtypjes pas 28 ditëve (EN 1015-11)	ca. 2,0 N/mm2					
Elasticiteti pas 28 ditëve (EN 1015-11)	ca. 0,5 N/mm2					
Vlera - pH	ca. 8,5					
Shkalla e transmetimit të avullit të ujit EN 15824:2017	V 1 - kategoria					
Athezioni ne bazament EN 15824:2017	> 0.3					
Kapaciteti specifik i nxehtësisë	ca. 1 J/kg K					

Me këtë listë të gjitha të dhënat e mëparshme për materialin bëhen të pavlefshme. Këto të dhëna janë të vlefshme për testimet tona të tanishme. Nga këto të dhëna nuk mund të dalë detyrim juridik. Prodhimet RENOVA, si dhe të gjitha lëndët e para përbërëse janë gjithmonë nën kontroll të vazhdueshëm me qëllim të ruajtjes në vazhdimësi të cilësisë së njejtë. Konsulentët tanë teknik janë gjithmonë në dispozicion tuaj në lidhje me punën, përdorimin dhe prezantimin e prodhimeve tona. Gjendjen aktuale të të dhënave teknike mund ta gjeni në web faqen tonë të internetit; www.renova.com.mk, si PDF ose mund t'i kërkonte ato ne sektori e shitjes.

RENOVA MAQEDONI

Xhepcisht / Tetove

Tel: +389 44 487 300

Fax: +389 44 487 200

info@renova.com.mk

RENOVA SHQIPERI

Picar / Vore

Tel: +355 48 301 909

Fax: +355 48 301 908

tirana@renova.com.mk

RENOVA KOSOVE

Gurëza / Ferizaj

Tel: +381 290 310 222

Fax: +381 290 310 444

ferizaj@renova.com.mk

COMPANY CERTIFIED BY



EN ISO 9001

Certificate No: FM 503328